

VENDIM
Nr.554, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2/I, vlera 12 000 lekë bëhet 13 000 lekë.

c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Punonjësit mësimorë që punojnë brenda rrethit të tyre jashtë qendrave urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, përfitojnë shpërblim deri në 1800 lekë në muaj.

Punonjësit mësimorë që punojnë brenda rrethit të tyre jashtë qendrave urbane, por mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre përfitojnë shpërblim deri në 5250 lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha